



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada – Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 01-325  
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Kolegji AAB- Qendra Gjermane e Kompetencës në Prishtinë me adresë Zona Industriale Fushë Kosovë, për periudhën 15.09.2017 deri 15.09.2020 me kualifikimet:
  - 1.1. **Furnitor, Niveli IV sipas KKK me 60 kredi të AAP.**
  - 1.2. **Asistent Administrativ, Niveli IV sipas KKK me 60 kredi të AAP.**
  - 1.3. **Specialist i Sigurisë Kibernetike, Niveli V sipas KKK me 120 kredi të AAP.**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

### **Furnitor**

- 2.1. Sigurimi i hapësirës, mjeteve, pajisjeve dhe mjeteve tjera përcjellëse për realizimit të orëve të praktikës nga kandidatët. Nëse aplikimi është për 40 candidate, atëherë duhet të ofrohet "tavolina e punës" për secilin kandidat, duke plotësuar se paku kriterin minimal të parapare në standardin e profesionit.
- 2.2. Secili kandidat i regjistruar në një cikël për kualifikim në këtë profil të ketë nga një vend pune me pajisjet siç janë të përcaktuara me standardin e profesionit, e ato janë: llaptopi ose kompjuteri, printeri, tabela, aparati, katalogë, reklamata e prodhimeve, prodhimet e ndryshme bujqësore si dhe mjete të tjera për përpilimin dhe realizimin e planit të hulumtimit të tregut si dhe pajisjet dhe veshjet mbrojtëse në punë dhe mjetet e duhura për trajtimin apo deponimin e materialeve të dëmshme.
- 2.3. Angazhim i një numri me të madh të stafit mësimdhënës të profesionit (se paku në raportin 1 trajner me 10 kandidatë)

## **Asistent Administrativ**

- 2.1. Institucioni duhet të hartoj rregullore si dokument i veçantë- manualin dhe procedurat nga aplikimi, ndjekja e trajnimit, vlerësimi deri tek marrja e certifikatës për profilin Asistent Administrativ.
- 2.2. Institucioni duhet të hartoj paketën mësimore me sistemin modular si pas standardeve ose duke ju referuar standardit profesional Asistent Administrativ.
- 2.3. Institucioni duhet të zhvilloi testin përfundimtar konform sistemit modular.
- 2.4. Institucioni duhet të hartoi formularin e vlerësimit të performancës së trajnerëve nga kandidatët.

## **Specialist i Sigurisë Kibernetike**

- 2.1. Të vendoset emri zyrtar sipas certifikatës së biznesit pasi që AAB- QGJK operon sipas atij emri.
  - 2.2. Të dëshmohen marrëveshje të reja bashkëpunimi për punën praktike të studenteve.
  - 2.3. Të hartohen dhe ofrohen ekzemplarë të paketave mësimore për të gjitha lëndet.
  - 2.4. Të ofrohen ekzemplarë të testeve të rregullta dhe të projekteve finale për të gjitha lëndët.
  - 2.5. Të respektohet standardi që mësimdhënësi të mos angazhohet më shumë se katër (4) orë mësimore në ditë
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datat 15.11.2017 sipas raporteve të jashtme vlerësuese për secilin kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

## **A r s y e t i m**

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

### Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- AAB/QGJK ;

- AKK.



Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së